



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1051, datë 21.12.2020

P Ë R

MIRATIMIN, NË PARIM, TË MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPITIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË,
“PËR REHABILITIMIN E SHKOLLËS 9-VJEÇARE “ILIRIA”
NË FUSHË-KRUJË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin, në parim, të memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë, “Për rehabilitimin e shkollës 9-vjeçare “Iliria” në Fushë-Krujë, Republika e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I SHTEBIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

MEMORANDUM MIRËKUPtimi

NDËRMJET

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË

DHE

KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR

“REHABILITIMIN E SHKOLLËS 9-VJEÇARE “ILIRIA” NË FUSHË-KRUJË, REPUBLIKA E SHQIPËRISË”

Qeveria e Republikës së Kroacisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (në vijim të referuar si "Pjesëmarrësit"),

DUKE PASUR PARASYSH SE Qeveria e Republikës së Kroacisë ka vendosur në datën 13 shkurt 2020 të mbështesë procesin e rimëkëmbjes së sektorëve më të dëmtuar në Republikën e Shqipërisë si pasojë e tërmetit që ndodhi më 26 nëntor 2019 në Republikën e Shqipërisë,

Kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

NENI 1

Objektivi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (në vijim i referuar si MM) është rregullimi i parimeve themelore të ekzekutimit të projektit "Rehabilitimi i shkollës 9-vjeçare "Iliria" në Fushë-Krujë, Bashkia Krujë, e dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit (në vijim i referuar si "Projekti"), në formën e një kontributi të dhënë nga Qeveria e Republikës së Kroacisë dhe brenda qëllimit dhe kushteve teknike të përcaktuara nga Pjesëmarrësit dhe legjislacioni i tyre kombëtar përkatës.
2. Ky kontribut, me qëllim rehabilitimin e objektit arsimor të lartpërmendur, në vlerën totale deri në 1,000,000.00 EURO (një milion Euro), është pjesë e zotimit të Qeverisë së Republikës së Kroacisë në Konferencën e Donatorëve "Së bashku për Shqipërinë", të zhvilluar në Bruksel më 17 shkurt 2020 nën kujdesin e Komisionit Evropian.
3. Brenda kuadrit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, kontributi i Qeverisë së Republikës së Kroacisë do të pranohet dhe administrohet nga Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (referuar si "PNUD"), me PNUD-in që vepron si Njësia Zbatuese për zbatimin e Projektit, në përputhje me Marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe PNUD-it.

4. Pas një verifikimi të specializuar të qëllimit të punës, PNUD-i do të vijojë me riparimin e objektit arsimor të lartpërmendur. Nëse kostot e riparimit tejkalojnë ose janë të barabarta me 70% të një ndërtimi të ri, atëherë PNUD-i do të vijojë me ndërtimin e ri të objektit arsimor, me miratimin e institucioneve përkatëse të Qeverisë.

NENI 2

Dispozitat ligjore

1. Kontributi i ofruar në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse në rast të katastrofave natyrore, brenda kuadrit të procesit të rindërtimit, përfshirë Ligjin Nr. 97/2019, në lidhje me miratimin e aktit normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë "lidhur me pasojat e fatkeqësisë natyrore", si dhe përjashtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH).

NENI 3

Detyrimet e pjesëmarrësve

1. Brenda qëllimit të këtij Projekti, Bashkia e Krujës në Republikën e Shqipërisë do të veprojë si Pronari i Projektit. Pronari i Projektit do të sigurojë një tokë të përshtatshme dhe sipërfaqe të mjaftueshme në pronësi të tij për zbatimin e Projektit pa pagesë. Pronari i Projektit do të garantojë vënien në dispozicion të kantierit të ndërtimit, heqjen e të gjitha mbetjeve, si dhe disponueshmërinë e dokumentacionit të nevojshëm (lejet, licencat, autorizimet etj) për kontraktuesin / ndërtuesin e zgjedhur nga PNUD-i, për zbatimin e plotë të këtij Projekti.

Pronari i Projektit do të përfundojë një Memorandum Bashkëpunimi me PNUD-in, me qëllim që të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella për zbatimin e plotë të Projektit dhe do të lehtësojë në mënyrë aktive zhvillimin e Projektit.

2. Projektet e ndërtimit dhe zbatimit për zbatimin e Projektit do të koordinohen dhe mbikëqyren nga Zyra e Ministrisë së Shtetit për Rindërtim, e cila do të bashkëpunojë në mënyrë aktive me PNUD-in.

3. Projektet e prokurimit, ndërtimit dhe zbatimit do të ekzekutohen nga PNUD-i. Projekti dhe normat e zbatimit do të jenë në përputhje me standardet arsimore, shëndetësore dhe të cilësisë të Shqipërisë dhe BE-së, të certifikuara nga Komisioni Europian dhe parimet e "Build Back Better".

4. Të gjitha detyrimet ligjore të palëve të treta në kantierin e ndërtimit (shpronësimi) do t'i përkasin autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Bashkinë.

5. Pjesëmarrësit do të marrin në konsideratë dhe do të bien dakord reciprokisht për projektet e zbatimit në lidhje me ekzekutimin e Projektit, të përgatitura nga PNUD-i. Kostot totale të Projektit do të llogariten në funksion të projekteve të miratuara.

6. Dorëzimi i Projektit pas përfundimit të tij do të kryhet ndërmjet përfaqësuesve të Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Pronarit të Projektit

NENI 4 **Grupi i punës**

1. Për qëllim të zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, palët do të krijojnë një grup pune jo më vonë se dy (2) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Memorandumi Mirëkuptimi. Grupi i Punës do të jetë në kontakt për përfundimin e Projektit brenda afatit të caktuar dhe për eliminimin e menjëhershëm të problemeve që mund të ndodhin.

NENI 5 **Hyrja në fuqi kohëzgjatja dhe amendimet**

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit me shkrim me të cilin pala shqiptare njofton palën kroate mbi përfundimin e procedurave ligjore kombëtare për hyrjen e tij në fuqi.
2. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e Projektit. Çdo Pjesëmarrës mund të njoftojë Pjesëmarrësin tjetër për synimin e tij për të përfunduar këtë Memorandum Mirëkuptimi me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike tre (3) muaj para. Përfundimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi nuk do të ndikojë në aktivitetet dhe projektet tashmë në progres ose të ekzekutuara.
3. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet në çdo kohë, me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Pjesëmarrësve. Ndryshime të tilla shtesë do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

NENI 6 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave midis Pjesëmarrësve.

NENI 7 **Konfidencialiteti i informacionit**

1. Pjesëmarrësit do të përdorin informacionin, dokumentet dhe projektet që ata shkëmbejnë ndërmjet tyre për ekzekutimin e Projektit vetëm për qëllimet e përcaktuara brenda kuadrit për të cilin kanë rënë dakord dhe nuk do t'i transferojnë tek palët e treta pa pëlqimin me shkrim të Pjesëmarrësit tjetër.

NENI 8

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi përfaqëson një mirëkuptim të arritur ndërmjet Pjesëmarrësve për çështjen e përmendur në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Nënshkruar në në datën / / 2020 në dy kopje origjinale, në gjuhën kroate, shqipe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentikë. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR

PËR

QEVERINË E REPUBLIKËS
SË KROACISË


KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

NR.PROT. 6489/1
DATË 23. / 2. 2020

MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Agaci', written over the printed name.